



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2974/15 prot.

Datë 21.02.2024

V E N D I M
Nr. 203/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 21.02.2024, mori në shqyrtim çështjen me,

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 141/2024, datë 06.02.2024 për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-84064-10-17-2023, me objekt: “Shërbimi i pastrimit dhe dezinfektimit për objektet e OSSH Sh.A dhe objektet në administrim të FSHU Sh.A”, me fond limit 32,253,174.3 lekë (pa TVSh), zhvilluar më datë 07.11.2023, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria Rajonale Tiranë e OSSH ShA.
- Ankimues:** Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Air” SHPK & “Silver” SHPK, me NIPT L51712008C dhe adresë: Rruga “Siri Kodra”, Nr.8340, Nr. Pasurie 5/450, Njësia Administrative Nr.8, Tiranë.
- Operatori ekonomik “Alko Impex Construction” SHPK me NIPT K91628013D dhe adresë: Njësia Bashkiake Nr. 9, Rruga “Asim Vokshi”, Alb building 2t, kati i 2, Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Drejtoria Rajonale Tiranë e OSSH ShA, me adresë: Rruga “Reshit Petrela”, përballë Dispanserisë, Tiranë
- Subjekte të interesuar:** Operatori ekonomik “Clean Fast” SHPK me NIPT L61807037R dhe adresë: Bulevardi “Bajram Curri”, Godina ETC, Kati 13, Tiranë
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për

miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”. Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 06.02.2024, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 141/2024, datë 06.02.2024, ku vendosi:

[...]

- 1. Të pranojë pjesërisht ankesën e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Air” SHPK & “Silver” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-84064-10-17-2023, me objekt: “Shërbimi i pastrimit dhe dezinfektimit për objektet e OSSH Sh.A dhe objektet në administrim të FSHU Sh.A”, me fond limit 32,253,174.3 lekë (pa TVSh), zhvilluar më datë 07.11.2023, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria Rajonale Tiranë e OSSH Sh.A.*
- 2. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Alko Impex Construction” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.*
- 3. Autoriteti kontraktor të rishikojë arsyet e skualifikimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Air” SHPK & “Silver” SHPK, dhe t’i pasqyrojë ato në sistemin e prokurimit elektronik.*
- 4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
- 5. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Air” SHPK & “Silver” SHPK.*
- 6. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifave financiare të paguara nga operatori ekonomik “Alko Impex Construction” SHPK.*
- 7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
- 8. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 44/3 prot., datë 15.02.2024, protokolluar me tonën me nr. 2974/12 prot., datë 19.02.2024, autoriteti kontraktor Drejtoria Rajonale Tiranë e OSSH Sh.A, njofton se ka zbatuar vendimin Nr. 141/2024, datë 06.02.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-84064-10-17-2023, me objekt: “*Shërbimi i pastrimit dhe dezinfektimit për objektet e OSSH Sh.A dhe objektet në administrim të FSHU Sh.A*”, me fond limit 32,253,174.3 lekë (pa TVSh), zhvilluar më datë 07.11.2023, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria Rajonale Tiranë e OSSH ShA.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me anë të shkresës nr. 44/3 prot., datë 15.02.2024, protokolluar me tonën me nr. 2974/12 prot., datë 19.02.2024, autoriteti kontraktor Drejtoria Rajonale Tiranë e OSSH Sh.A, njofton se ka zbatuar vendimin Nr. 141/2024, datë 06.02.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-84064-10-17-2023, me objekt: “*Shërbimi i pastrimit dhe dezinfektimit për objektet e OSSH Sh.A dhe objektet në administrim të FSHU Sh.A*”, me fond limit 32,253,174.3 lekë (pa TVSh), zhvilluar më datë 07.11.2023, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria Rajonale Tiranë e OSSH ShA.

Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe verifikimeve të kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, konstatohet se, autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin e procedurës së mësipërme të prokurimit, në përputhje me vendimin K.P.P. 141/2024, datë 06.02.2024 të Komisionit të Prokurimit Publik.

II.2. Sa më sipër, autoriteti kontraktor Drejtoria Rajonale Tiranë e OSSH Sh.A, ka zbatuar vendimin K.P.P 141/2024, datë 06.02.2024 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, nenit 46 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-84064-10-17-2023, me objekt: “*Shërbimi i pastrimit dhe dezinfektimit për objektet e OSSH Sh.A dhe objektet në administrim të FSHU Sh.A*”, me fond limit 32,253,174.3 lekë (pa TVSh), zhvilluar më datë 07.11.2023, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria Rajonale Tiranë e OSSH ShA.
 2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri

